



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-CA-2023-02

**Vendosi:** Kryegjykatësja e Panelit të Dhomës së Gjykatës së Apelit  
Gjykatëse Mishelë Pikar

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 9 shkurt 2023

**Gjuha origjinale:** Anglisht

**Klasifikimi:** Publik

---

**Urdhër për Caktimin e Datës të Konferencës Para Apelit**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**  
Aleks Uajting

**Mbrojtjes së Salih Mustafës:**  
Julius von Bone

**Mbrojtëses së Viktimave:**  
Ani Pues

**KRYEGJYKATËSJA E PANELIT TË DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT** të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht “Kryegjykatësja”, “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”)<sup>1</sup> në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 172 të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”) lëshon këtë urdhër.

1. Më 24 shtator 2020, z. Salih Mustafa (“Mustafa” ose “i akuzuari”) u arrestua dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së.<sup>2</sup>
2. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykses lëshoi aktgjykimin (“Aktgjykimi”), duke e shpallur të akuzuarin fajtor për tre pika të Aktakuzës dhe të pafajshëm për një pikë, dhe e dënoi atë me dënim të njësuar me 26 vjet burgim, në të cilin llogaritet koha e paraburgimit.<sup>3</sup>
3. Më 9 janar 2023, Paneli i Apelit miratoi kërkesën e të akuzuarit për zgjatje deri më 3 shkurt 2023 të afatit për të parashtruar njoftimin për apel kundër Aktgjykimit.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> F00007, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 7 shkurt 2023 (konfidencial, riklasifikuar si publik më 7 shkurt 2023).

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-05, F00013, Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4), 24 shtator 2020 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si publik më 16 nëntor 2020); KSC-BC-2020-05, F00014, Njoftim për Pranim në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 24 shtator 2020 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si publik më 16 nëntor 2020).

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-05, F00011/RED/A01, Version i Redaktuar Publik i “Aktakuzës”, i datës 19 qershor 2020, 2 tetor 2020 (version rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* parashtruar më 19 qershor 2020) (“Aktakuza”); KSC-BC-2020-05, F00494/RED/COR, Version i Korrigjuar i Versionit të Redaktuar Publik të Aktgjykimit, 24 janar 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 16 dhjetor 2022, versioni i pakorrigjuar publik u dorëzua në 19 janar 2023), para. 831. Trupi Gjykses e dënoi Mustafën për ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje si krime lufte, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të Aktakuzës, dhe e shpalli të pafajshëm për trajtim mizor si krim lufte sipas pikës 2 të Aktakuzës. Shih Aktgjykimin, para. 831. Shih edhe KSC-BC-2020-05, F00491, Urdhër për Caktimin e Datës për Shqiptimin e Aktgjykimit, 6 dhjetor 2022.

<sup>4</sup> F00001, Mocion Urgjent i Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit të Apelit, 3 janar 2023; F00004, Vendim mbi Mocionin Urgjent të Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit të Apelit, 9 janar 2023.

4. Më 2 shkurt 2023, i akuzuari dorëzoi njoftimin për apel kundër Aktgjykimit (“Njoftim për Apel”).<sup>5</sup>

5. Paraprakisht, Kryegjykatësja konstaton se megjithëse Trupi Gjykues ka nxjerrë një version të redaktuar publik të Aktgjykimit, i akuzuari nuk ka paraqitur ndonjë version të redaktuar publik të njoftimit për apel. Kryegjykatësja vëren se të gjitha parashtrimet e dorëzuara Dhomave të Specializuara janë publike, përveç nëse ka arsye të veçanta për t’u mbajtur konfidenciale, dhe se palët i dorëzojnë Panelit sa më shpejt që të jetë e mundur versionet e redaktuara publike të të gjitha parashtrimeve jopublike të dorëzuara, duke mos pritur të marrin urdhër nga Paneli.<sup>6</sup> Si pasojë, Kryegjykatësja urdhëron të akuzuarin të paraqesë brenda **të martës, 13 shkurt 2023, ora 12:00** një version të redaktuar publik të Njoftimit për Apel.

6. Gjithashtu, rregulla 178 e Rregullores përcakton se:

Brenda njëzet e një (21) ditësh nga njoftimi për apel, dhe kur çmohet e nevojshme pas kësaj, kryegjykatësi i panelit ose gjykatësi raportues nëse është caktuar, thërret një konferencë për t’i mundësuar çdo personi të paraburgosur në pritje të apelit të ngrejë çështje lidhur me apelin, përfshirë edhe lidhur me gjendjen mendore dhe fizike të personit.

7. Në përputhje me këtë, Kryegjykatësja cakton mbajtjen e një Konference Para Apelit **të enjten, më 16 shkurt 2023, në 10:00**.

8. Gjatë seancës Kryegjykatësja do të kërkojë parashtrime të palëve, mbrojtëses së viktimave dhe/ose administratores, sipas rastit, në lidhje me:

- (i) Apelin e pritshëm të të akuzuarit kundër paraburgimit, duke përfshirë edhe gjendjen e tij mendore e fizike, në përputhje me rregullën 178 të Rregullores;

---

<sup>5</sup> F00006, Njoftim për Apel i Mbrojtjes në bazë të rregullës 176 (të Rregullores së Procedurës dhe Provave) kundër Aktgjykimit të Trupit Gjykues I të 16 dhjetorit 2022, 2 shkurt 2023 (konfidencial).

<sup>6</sup> Shih p.sh. KSC-CA-2022-01, F00103, Vendim mbi Kërkesën e Gucatit për Riklasifikim ose Versione të Redaktuara Publike të Vendimeve të Panelit të Gjykatës së Apelit, 9 janar 2023, para. 2.

- (ii) Përparimin e bërë në përkthimin e Aktgjykimit në shqip, dhe kur pritet përfundimi i tij; dhe
- (iii) Çdo çështje tjetër që mund të dëshirojë të shtrojë Kryegjykatësja.

9. Kryegjykatësja udhëzon palët dhe mbrojtësen për viktimat që brenda **të hënës, 13 shkurt 2023, ora 12:00**, të njoftojnë atë, palët e tjera dhe mbrojtësen për viktimat me postë elektronike për çdo çështje tjetër që do të duan të shtrojnë në Konferencën Para Apelit.

10. Në përputhje me rregullat 96(2) dhe 173(3) të Rregullores, Kryegjykatësja udhëzon Mbrojtjen që brenda **të hënës, 13 shkurt, 2023, ora 12:00** të njoftojë me postë elektronike Njësinë e Administrimit të Gjykatës nëse i akuzuari dëshiron të marrë pjesë në Konferencën Para Apelit dhe/ose nëse i akuzuari dhe/ose Mbrojtja dëshirojnë të marrin pjesë nëpërmjet videokonferencës. Në rast se i akuzuari nuk dëshiron të marrë pjesë në Konferencën Para Apelit, Mbrojtja duhet të dorëzojë në të njëjtën mënyrë dhe brenda të njëjtës datë dhe orë parashtrimet përkatëse për mospjesëmarrjes.

11. Për këto arsye, Kryegjykatësja e Panelit të Gjykatës së Apelit:

**CAKTON DATËN** e Konferencës Para Apelit **të enjten, më 16 shkurt 2023, në 10:00;**

**UDHËZON** Mbrojtjen që të njoftojë brenda **të hënës, 13 shkurt 2023 në 12:00**, dhe në formën e përcaktuar më lart në paragrafin 10, nëse i akuzuari dëshiron të marrë pjesë në Konferencën e Para Apelit dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë parashtrimet përkatëse për mospjesëmarrje;

**UDHËZON** palët dhe mbrojtësen e viktimave të njoftojnë me postë elektronike Kryegjykatësen dhe palët e tjera dhe mbrojtësen e viktimave brenda **të hënës,**

**13 shkurt 2023, në 12:00**, për çdo problem tjetër që do të duan të shtrojnë gjatë Konferencës Para Apelit; dhe

**URDHËRON** Mbrojtjen të dorëzojë brenda të hënës, **13 shkurt 2023 në 12:00** një version të redaktuar publik të Njoftimit për Apel.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatëse Mishelë Pikar,**  
**Kryegjykatëse**

E enjte, 9 shkurt 2023

Në Hagë, Holandë